



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-075 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregullën 15/2013, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme, si dhe bazuar në vendimin e KQZ-së Nr.01/1361/2022, të datës 15.11.2022, për Caktimin e Afateve të Aktiviteteve Zgjedhore për Zgjedhjet të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.11.2022, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rekomandimit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit të KQZ-së Nr.01/1361/2022, të datës 15.11.2022, për Caktimin e Afateve të Aktiviteteve Zgjedhore për Zgjedhjet të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan

- I. Miratohet rekomandimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të KQZ-së, Nr.01/1361/2022, të datës 15.11.2022, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen më datë 18 dhjetor 2022.
- II. Rekomandimi, si në pikën I është pjesë përbërse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.11.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



<i>Data</i>	21.11.2022	Ref. Nr.
<i>Për</i>	KQZ-së	
<i>Nga</i>	Këshilli për Operacione Zgjedhore	
<i>Kopje</i>	Arkivës së KQZ-së	
<i>Lënda</i>	Rekomandim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të KQZ-së Nr.01/1361/2022, të datës 15.11.2022, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen më datë 18 dhjetor 2022	

Të nderuar anëtar të KOZ-it,

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP), rekomandon Këshillit të Operacioneve Zgjedhore, shterjen e afateve sipas pikave vijuese:

Rekomandimi :

Rekomandim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të KQZ-së Nr.01/1361/2022, të datës 15.11.2022, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen më datë 18 dhjetor 2022.

- a) Afati për aplikim për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje të shtyhet nga 21 nëntor deri më 25 nëntor 2022;
- b) Afati për paraqitjen e përmirësimeve/korrigjimeve nga subjekteve politike të shtyhet prej 26 nëntor deri në 28 nëntor 2022;
- c) Afati për vendimmarrjen e KQZ-së për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të shtyhet prej 26 nëntor deri më 28 nëntor 2022;
- d) Afati për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve politike të shtohet prej 27 nëntor deri më 28 nëntor 2022.
- e) Afati për Emërimin e KKZ-ve shtyhet prej 24 nëntor deri me datën 28 nëntor 2022.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe vendimit të KQZ-së Nr.01/1362/2022, të datës 15.11.2022, për miratimin e Planit Operacional për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.11.2022, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rekomandimit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit të KQZ-së Nr.01/1362/2022, të datës 15.11.2022, për Miratimin e Planit Operacional për Zgjedhjet të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan

- I. Miratohet rekomandimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të KQZ-së Nr.01/1362/2022, të datës 15.11.2022, për miratimin e Planit Operacional, për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen më datë 18 dhjetor 2022.
- II. Rekomandimi, si në pikën I është pjesë përbërse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.11.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Kreshnik Radonija




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



<i>Data</i>	21.11.2022	Ref. Nr.
<i>Për</i>	KQZ-së	
<i>Nga</i>	Këshilli për Operacione Zgjedhore	
<i>Kopje</i>	Arkivës së KQZ-së	
<i>Lënda</i>	Rekomandim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të KQZ-së Nr.01/1362/2022, të datës 15.11.2022, për miratimin e planit operacional për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen më datë 18 dhjetor 2022.	

Të nderuar anëtar të KOZ-it,

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve , rekomandon Këshillit të Operacioneve Zgjedhore, shterjen e afateve sipas pikave vijuese:

Rekomandimi :

Rekomandim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të KQZ-së Nr.01/1362/2022, të datës 15.11.2022, për miratimin e planit operacional për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen më datë 18 dhjetor 2022.

- Afati për miratimin e Planit Operacional të Sigurisë shtyhet deri me datën 25 nëntor 2022.

Me respekt,